



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 215, Datë 14.10.2024

MBI

ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “PARISOL” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1854/5 prot., datë 10.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “PARISOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “PARISOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1853 prot., datë 02.09.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 2MW dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 183, datë 12.09.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.09.2024 dhe 14.09.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 24.09.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtore të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1927 prot., datë 16.09.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e kësaj procedure.
- Me shkresën nr. 1853/3 prot., datë 30.09.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet nga ky aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1853/4 prot., datë 09.10.2024, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues për këtë aplikim.
- Në nenin 14, pika 3 të Rregullores parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Për gjithë sa më sipër, me qëllim marrjen e kohës së nevojshme për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria për të saktësuar dokumentacionin financiar, sqaruar mbështetjen financiare dhe për të parë vendimet e Asamblesë së Shoqërisë, vlerësojmë të zgjatet deri në 10 (dhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “PARISOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 10 (dhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “PARISOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “PARISOL” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI